

VENDIM
Nr. 839, datë 21.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. MYZAFAER ZAIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 600 000 (gjashtëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të kurimit të z. Myzafer Zaimi.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha